



VENDIM

Nr. 37 Datë 05.04.2012

**PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË RISIKUAR TË INVESTIMEVE TË CEZ
SHPERNDARJE SH.A P PËR PERIUDHËN E TRETË
RREGULLATORE 2012-2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 05.04.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e Planit të Rishikuar të Investimeve të CEZ Shpërndarje sh.a për periudhën e tretë Rregullatore 2012-2014, si dhe në vijim të vendimmarrjes së saj nr. 143, datë 07.12.2011, për miratimin me kusht të Planit të Investimeve të CEZ Shpërndarje sh.a për periudhën e tretë rregullatore (2012 - 2014),

Konstatoi se:

Plani i Rishikuar i investimeve i shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, i paraqitur në ERE, pas vendimmarrjes me kusht, është përmirësuar mjaftueshëm si më poshtë:

- Nga pikëpamja e vlerave të investimeve të shpërndara sipas grupimeve konstatohet se përmirësohen raportet e investimeve sipas studimit për reduktimin e humbjeve.
- Në zërin investime në proces dallohet qarte tendenca e uljes së vlerave të mbartura për vitin pasardhës.
- Në zërin investime në N/Stacione është reflektuar sugjerimi i ERE-s.
- Në zërin investime në matje është reflektuar sugjerimi për shtyrjen e investimeve në matësat me parapagese dhe është planifikuar plotësimi i matjes në N/St dhe Kabina.
- Zëri i investimeve prioritare është detajuar mjaftueshëm dhe dallohet tendenca për të kryer investime që tentojnë uljen e humbjeve dhe sigurinë e furnizimit.

Aplikimi i CEZ Shpërndarje sh.a për Planin e Rishikuar të Investimeve për periudhën e tretë Rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi:

1. Të miratoje, Planin e Rishikuar të Investimeve të CEZ Shpërndarje sh.a për periudhën e tretë rregullatore (2012 - 2014). (Plani i Investimeve bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e CEZ Shpërndarje sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.